



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Biblioteka e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, shpall konkurs për pozicionin e punës personel ndihmësakademik me kohë të plotë, bibliotekar.

Personeli ndihmësakademik me karakter administrativ, *bibliotekar i* shërben në bibliotekë studentëve dhe personelit akademik (përdoruesit); regjistron treguesit kryesorë të punës së bibliotekës (qarkullimin, frekuentimin, etj); i sugjeron përdoruesve literaturën e nevojshme; realizon trajtimin dhe ruajtjen e stokut të bibliotekës; arkivon literaturën e papërdorshme, sipas rregullave dhe rregulloreve në fuqi; respekton rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes nga zjarri; përgjigjet për realizimin e detyrave të ngarkuara me përpikmëri dhe nivel të lartë profesional; raporton periodikisht tek eprorët Brenda afateve.

Kandidati duhet të plotësojë këto kritere të përgjithshme e të veçanta:

Kritere të përgjithshme:

- Të zotërojë diplomë të ciklit të dytë të studimeve, ose ekuivalente me të. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura dhe njehsuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.
- Të këtë përvojë të mëparshme pune.
- Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- Ndaj tij të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- Të jetë i aftë për punë.

Kritere të veçanta:

- Të këtë njohuri të paktën të një gjuhe të huaj (preferohet anglisht) të vërtetuar me dokumentacion.
- Të këtë mbi 1(një) vit përvojë pune.
- Të jetë njohës i mirë i përdorimit programeve kompjuterike, word/excel.
- Të këtë aftësi të mira komunikuese e të punës në grup.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” brenda 10 (dhjetë) ditëve (**26.02.2024 – 06.03.2024**) nga data e shpalljes në www.app.gov.al dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- Letër motivimi për pozicionin e punës *bibliotekar* në Bibliotekën e Universitetit të Elbasanit;
- Jetëshkrimin e tij/saj;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

- Fotokopje e diplomës e njehsuar me origjinalin. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njehsuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- Fotokopje e listës së notave e njehsuar me origjinalin. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
- Fotokopje e njehsuar e librezës së punës;
- Çertifikata, kualifikime, dëshmi, rekomandime për aftësi të ndryshme, të njehsuara me origjinalin;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njehsuar me origjinalin;
- Raport i gjendjes shëndetsore, që vërteton aftësinë për punë;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Librezë shëndetsore

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (26.02.2024 – 06.03.2024) nga data e shpalljes në www.app.gov.al në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyta”,
Aplikim për pozicionin e punës: *bibliotekar*
Elbasan**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e Rektoratit. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do të nënshtohen intervistës me gojë (08.03.2024 – 27.03.2024). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen/njoftimi i fituesit.